



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga: Abdi Toptani nr. 2, Tiranë;

E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 418/4Prot.

Tiranë, më 27/06.2018

V E N D I M

Nr.59, Datë 27/6/2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINE RAJONALE TE MJEDISIT KORÇË, "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË NË AKTIVITETIN E MONITORIMIT DHE MBROJTJEN E MJEDISIT".

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin e monitorimit dhe mbrojtjen e mjedisit*", të ushtruar në DRM Korçë për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIM PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

1. **Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave dhe dokumentacionit përkatës të **42 praktikave** për vitet 2015-2017, për dhënie mendimi për VNM paraprake e të thelluar për leje mjedisore Tip B sipas aktiviteteve: "*Gurore*" 16 praktika, "*Vend-depozitim inertesh*" 16 praktika, "*Shfrytëzim miniera*" 10 praktika si dhe të 5 praktikave për dhënie mendimi për Leje të Tipit A e B për aktivitetet "*Prodhim*".

ndërtimi, nyje betoni” 11 praktika, “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme” 1 praktikë, “Prodhim-tregtim Gaz” praktikë, “Trajtime me regjie dhe prodhim i lëkurës” 1 praktikë, Gurore 3 praktika, Miniera 6 praktika, “Vend-depozitime mbetjesh inerte”. Nga këto në 7 **praktika** u konstatuan mangësi e mungesën e miratimit nga AKM Tiranë të formularëve standard, mungesë përfshirje e mos cilësim të dhënash në rubrikat përkatëse të formularëve të VNM-ve mitatuara nga AKM, lidhur me mospërcaktimet e statusit pronësor, shtrirjes territoriale dhe juridiksionit të aseteve, resurseve e pasurive (mosidentifikimin e tyre) sipas përkatësisë së NJVQV-ve. Kjo ka sjellë pasojë mos vendosjen e kushteve të rehabilitimit të sipërfaqeve të aseteve resurseve të tjetërsuara nga zhvillimi i VNM dhe lejes mjedisore, mos vendosjen nga AKM e kushteve lidhur me domosdoshmërinë e dokumentacionit që duhet mbajtur dhe mënyrën e hartimit të tyre gjatë verifikimit në terren. Konkretisht; akt-inspektimi, aktverifikimi, relacioni i specialistëve, mungesa e tërheqjes së mendimit të NJVQV-së dhe njohjes së saj me procesverbalin e konsultimit me publikun.

Këto mangësi në vendimmarrjen dhe procedurat e dhënies së lejes B (nga bashkëpunimi AKM Tiranë dhe DRM Korçë), kanë sjellë shqetësime sociale në komunitetet përkatëse të NJVQV-ve dhe territoret ku ushtrohen këto aktivitete, duke krijuar ndotje të lartë mjedisore. Këto mangësi për periudhën e mëparshme dhe aktualisht, kanë ardhur nga fakti se nuk është vlerësuar mendimi i NJVQV-ve me strukturat mjedisore të tyre edhe pse janë pronarë dhe posedues të territoreve në juridiksionin e tyre. Gjendja e krijuar, është në kundërshtim me nenet 26, 27 të ligjit nr.139/2015 datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Praktika e ndjekur nga AKM, Ministria përkatëse dhe DRM Korçë, ka ardhur edhe për faktin e mangësisë e mospërmbushjes së kërkesave të shprehura në Kreun III, pika 4, kreu VI, pika 12 dhe pika 16 të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja” (Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Drejtoria Rajonale (DRM) Korçë në bashkëpunim Agjencin Kombëtare të Mjedisit (AKM) Tiranë dhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, të vlerësojë problematikat e hasura në auditimin e DRM Korçë, e cila mbulon aktivitetin mjedisor të Qarkut të Korçë, në aktivitetet si: gurore, linja për prerje guri, pulari, përpunim lëkure etj, si dhe aktivitete të tjera lidhur me lejet e tipit A,B shtrirë në territoret me pronësi e juridiksion të NJVQV-ve, të cilat kanë sjellë shqetësime sociale në komunitetet përkatëse, ku ushtrohen këto aktivitete me ndotje të lartë mjedisore.

- Të merren masa për zgjidhje të qëndrueshme të këtyre problemeve, duke marrë iniciativë për ndryshime e përmirësim ligjor të VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipeve A, B dhe C, si dhe për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, për lejet respektive të mjedisit, si dhe të caktohen rregulla të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja “**konkretisht:** Kreu III “Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi I kushteve për Leje Mjedisit të Tipit B” pika 2, ku të shtohet pas germës c) germa ç), me citimin: “në të cilën të përfshihej marrja e mendimit edhe nga njësitë e NJVQV-ve përkatëse dhe jo vetëm njoftim i tyre”, për arsye se pasojat mjedisore zhvillohen në zonat, të cilat janë në juridiksion apo pronësi të NJVQV-ve.

Këto masa bëhen edhe më të domosdoshme aktualisht me kryerjen e reformës territoriale, mbështetur në rritjen e autonomisë dhe pavarësisë së NJVQV-ve përkatësisht në ligjet nr. 139/2015, datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe në akte të tjera nënligjore në zbatim të

tyre, të cilat duhet të reflektohen e përfshihen edhe në aktet nënligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe dhënien e lejeve mjedisore.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në formulimin e akteve të refuzimit të lejeve të tipit C, është konstatuar se mungojnë citimet në nenin apo pikën e bazës ligjore e nënligjore, dhe pikave të shtojcës përkatëse për secilin prej kushteve të paplotësuara, duke u mjaftuar vetëm me përmendjen apo citimin e ligjit, nr.10431 datë 09.06.2011“Për Lejet e Mjedisit”, si dhe mungojnë aktverifikimet ne terren dhe relacionet përkatëse të grupit të specialistëve për argumentimin e tyre (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1.Rekomandimi: DRM Korçë të marrë masa, që komisionet e shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve të përgatisin dhe formulojnë akt-refuzimet në mënyrë të plotë, duke i mbështetur shkaqet e refuzimit me bazen nënligjore dhe kushtete sipas pikave të shtojcës përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Korçë nuk ka të evidentuar listën e plotë të subjekteve të pajisur me Leje Mjedisore të Tipit C, mungojnë akt rakordimet periodike me DR Tatim Taksave Korçë, me QKL apo dhe me NJVQV-të (6 bashkitë) për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun Korçë e që kanë ndikim në mjedis dhe kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive, mundësinë e shprehjes me një tregues të përgjithshëm të evazionit në lejet mjedisore, lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis për Zonat (zonat me ndikim të lartë mjedisor). Kërkesa këto të ligjit nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për Lejet e Mjedisit”, ligji nr.1043, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar dhe paketës ligjore për mjedisin (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: DRM Korçë në bashkëpunim me AKM Tiranë të marrë masa për:

a. të evidentuar e ndjekur subjektet mbajtës të Lejeve Mjedisore të Tipit C, duke rakorduar me DRTT Korçë, me QKL me NJVQV-të për numrin e përgjithshëm të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në Qarkun e Korçë.

b. të hartuar një listë të subjekteve që kanë detyrimin e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e veprimtarive, të dhëna këto që do të siguronin ndjekjen dhe analizën e problematikës së mbrojtjes së mjedisit, procesin e liçensimit të subjekteve me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) për Qarkun.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve teknike për verifikimin dhe shqyrtimin e kërkesave për miratimin ose refuzimin e lejeve mjedisore, janë konstatuar mangësi në konceptim dhe formulim, nuk janë evidentuar diskutimet, situatat, zhvillimi i tyre, si dhe nuk kanë prezantuar para Drejtorit të DRM Korçë informacion të plotë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10448 datë 14.07.2011“Për lejet e mjedisit” dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014, “*Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja*”. Pavarësisht fluksit të vogël të aplikimeve për leje mjedisi në mbledhjet e komisionit, konstatohet se dosjet nuk janë studiuar mirë nga specialistët, mungojnë analizat dhe diskutimet cilësore për vendim-marrje sa më objektive. Nuk është dhënë referencë dhe argumentim ligjor për arsyet e refuzimit të kërkesave për leje mjedisi të tipit C (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: DRM Korçë të marrë masa që të pasqyrohet në procesverbalet e mbajtura të mbledhjes së komisioneve për leje mjedisi tipi C, informacioni i plotë për vlerësimin e dokumentacionit, duke argumentuar aktet e miratimit apo refuzimit me argumentet përkatëse. Për këtë në aktmiratime të përcaktohen zotërimi i dokumentave të pronësisë, dokumentimi i mendimit të NJVQV-së dhe informacion tjetër që lidhet me mbrojtjen e mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3.2.Rekomandimi: DRM Korçë të marrë masa që në përfundim të shqyrtimit të dosjeve për aplikim të lejeve, komisionet e shqyrtimit të lejeve të përgatisin akt-refuzimet, të cilat duhet të përmbajnë studimin e plotë të dosjes së aplikimit. Të citohen saktësisht dhe në mënyrë objektive arsyet e refuzimit, mangësitë ligjore dhe dispozitat përkatëse, duke kërkuar respektimin e kushteve apo kritereve ligjore që duhen plotësuar nga subjektet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi. Në procedurat e miratimit të lejeve të tipit C për periudhën 2015-2017 në lidhje me plotësimin e Aktit –miratimit dhe vendosjen e kushteve për mbrojtjen e mjedisit u konstatuan mangësi si:

-në pikën 3 të aktit të miratimit nuk janë vendosur e përmendur treguesit identifikues të marrëdhënieve të pronësisë, qerasë së objektit, koordinatat Gaus-Kruger, planimetritë e vendndodhjes, Harta treguese e rregjistrimit;

-në kushtin 4 “Njoftimet” në pikën 4.1.4, nuk është përcaktuar *afati si datë* pas 6 muajsh për dorëzimin e raportit dhe treguesve të vetëmonitorimit;

-në kushtin 3 “Operimi dhe infrastruktura” në nëkushtet e saj nuk është vendosur lloji i lëndëve dhe përcaktimi treguesve të cilësisë së ujerave që hyjnë në teknologjinë e përdorur si dhe kushti i distancës 1 km nga rruga kryesore;

-në kushtin 3 janë vendosur nënkushte në lidhje me dezinfektimin e ambienteve dhe zbatimin rigoroz i kushteve teknike në punë, të cilat nuk janë kompetencë e DRM Korçë,por janë kompetencë e (ISHP) dhe (IMSH);

-në kushtin 5”shkarkime” nuk janë përcaktuar nënkushte si “shkarkimi i gazrave në ajër”, “monitorimi dhe raportimi i gazrave” “shkarkimet në kanalizime “;

-në kushtin 6 “menaxhimi i mbetjeve” në kushtet e saj nuk janë përcaktuar mbetjet teknologjike të ngurta e të lëngshme, kontratat përkatëse të largimit të tyre, si dhe caktimi i vend-depozitimi të mbetjeve e planimetrisë nga NJVQV-ja. Këto mangësi janë në kundërshtim me shtojcën 6, pika 9, Kreu IV formulari akt-miratimit pika 10, germa a, b, c, ç ,dh” të VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, të cilat janë paraqitur në licencimin e aktiviteteve:

-“Përpunim druri e prodhim mobilje”, audituar 20 procedura nga 39 të licencuara

-“Servis automjeteve e gomisteri” audituar 35 procedura nga 77 të licencuara

-“Furnizim me karburant dhe gaz” audituar 22 procedura nga 32 të licencuara

-“Magazinim Frigoriferik ” audituar 7 procedura nga 11 procedura të licencuara

-“ Restorante e Fast-Food” audituar 12 procedura nga 58 procedura të licencuara

-“Furra të prodhimit të bukës” audituar 14 procedura nga 44 procedura të licencuara

-“Baxho përpunim Qumshti”, audituar 8 procedura nga 12 procedura të licencuara

-“Prerja, gdhendja e lustrimi i gurit” audituar 9procedura nga 13 të licencuara

-“Magazinim skrapit” audituar 7 procedura nga 14 procedura të licencuara

-“Përpunim,tregtim mat. ndërtimi“audituar 3 procedura nga 3 procedura të licencuar

“Qendër shëndetësore” audituar 4 procedura nga 15 procedura të licencuara

-“Larje e pastrim mjetesh motorike” audituar 1 procedurë nga 1 e licencuara(Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: DRM Korçë të marrë masa dhe të rishqyrtojë lejet e tipit C (LC) të lëshuara, përkatësisht:

- Për vitin 2015 në **79 raste**, për vitin 2016 në **48 raste** dhe për vitin 2017 në **33 raste**, duke hequr kushtet e vendosura jashtë kompetencave mjedisore dhe vendosur kushtet mjedisore përkatëse, përcaktimin e datës dhe treguesve të raportimit dhe vetmonitorimit.

-Të kërkojë plotësimin e kushteve të munguara dhe të verifikojë plotësimin e kushteve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet si: pluhurat, ujrata, kimikatet, vajrat e përdorura, mbetjet e ngurta apo të lëngëta, zhurmat etj, si dhe në mosplotësim të kushteve të anulojë lejet e lëshuara dhe të njoftojë Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (DR ISHMPU) Korçë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në DRM Korçë u konstatua se subjektet që paraqesin raportet e vetëmonitorimit, nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave, pasi mungojnë laboratorët shtetërorë, me ndihmën e të cilëve mund të sigurohet informacion mbi saktësinë e laboratorëve të akredituar sipas VKM nr. 1185 dt 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit në mjedis”. Ky vendim ka nevojë për ndryshime dhe përshtatje me kushtet e reja, që kanë sjellë mangësi në raportet e vetëmonitorimit (Trajtuar në faqet 108-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: DRM Korçë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) Tiranë të marrë masa që të parashikojnë fondet e nevojshme për paisje laboratorike, ose të lidhin kontrata me subjekte të licencuara dhe akredituara për marrjen e shërbimit të kërkuar për plotësimin e VNM me analiza shoqëruese.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për periudhën 2015-2017 në **61 raste** të procedurave të miratimit të lejeve të Tipit C, nuk ka zbatuar kërkesat e kreu të IV-të VKM nr.419, datë 25.06.2014 pika 2 dhe 3, ku citohet se: “... brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të aplikimit në NJVQV, e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3 (tre) ditëve pune..” (Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi DRM Korçë të marrë masa për dërgimin e kopjeve të aplikimit të subjekteve në NJVQV-në përkatëse dhe të respektojë afatin e pritjes së përgjigjes nga NJVQV, të cilat duhet të japin brenda tre ditëve mendimin me shkrim. Në mungesë të dhënies së mendimit nga NJVQV brenda afatit 3 ditor, DRM Korçë të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për pajisjen e subjektit me leje mjedisi tipi C, sipas dispozitave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për periudhën 2015-2017, nuk ka patur një program tërësor pune për bashkëpunimin dhe kryerjen e kontroleve të përbashkëta, përveç tre bashkëpunimeve për mbetjet urbane, për kushtet e lejeve të guroreve dhe fabrikave të lëkurave si dhe me 6 Bashkitë për mbetjet spitalore. Bashkëpunimi nuk është shtrirë me institucione si Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Korçë dhe Inspektoriatit Qendror Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore në përmbushje të kërkesave të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe kërkesave të përcaktuara në Kreu 5, germa pika 1/n, kreu 6, germa a e VKM nr.47, datë 29.1.2014 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit” (Trajtuar në faqet 116-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: DRM Korçë të marrë masa për hartimin e programit vjetor, ku në përbërje të tij të jenë planet e punës dhe programe kontrolli bashkëpunimi për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta me organet e tjera të kontrollit. Kjo në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet DRM Korçë dhe AKM Tiranë me organet e tjera të kontrollit, si me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (DR ISHMU) Korçë për informalitetin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga Auditimi: Drejtoria Rajonale e Mjedisit Korçë për periudhën 2015-2017, ka dhënë **324 mendime për Vlerësime të Ndikimit në Mjedis (VNM)** dhe për leje mjedisore për licencimet të Tipit A, B nga AKM. Për këto, me përjashtim të **83 mendimeve** të dhëna për veprat publike, DRM Korçë nuk ka informacione nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për **145 praktika të dhënies të mendimit**, nga të cilat: 116 mendime për VNM dhe 29 mendime për Leje Mjedisore me pasojë mosndjekjen e afateve dhe procedurave ligjore. Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr.1964, datë 13.11.2014 “Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit A, B dhe C. “Të dhënat sipas tabelës 7 të krahasimit të Rregjistrit të mendimeve për VNM dhe Lejeve Mjedisore tipi A-B për periudhën 2015-2017 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit” (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1.Rekomandim: DRM Korçë të kërkojë zyrtarisht nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM e Leje mjedisore A-B, me synim përditësimin në formë elektronike të rregjistrit të lejeve të tipit A,B sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si DR ISHMU, NJVQV-të dhe QKL.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga Auditimi: Në dokumentacionin e dosjeve për dhënien e mendimeve për VNM e Leje Mjedisore **në 69 raste**, nga të cilat **20 raste për VNM dhe 49 raste për Leje Mjedisore të tipit B, mungojnë praktikat e procesit të konsultimeve me publikun**. Megjithëse në shkresat e mendimeve shpreheshin se: “Është kryer procesi i konsultimit me publikun”. Për **111 raste të dhënies të mendimeve**, ku **35 raste për VNM dhe 75 për Leje Mjedisore të tipit B** janë kryer procedurat e konsultimit me publikun. Në këto praktika u konstatuan këto mangësi: mungon inventari praktikës, formularit të konsultimit i mungon data e plotësimit dhe kërkesat e subjekteve për konsultim janë të pa protokolluara nr, date; mungon procesverbal, protokoll i konsultimit i mbajtur për takimin e diskutimet i nënshkruar nga specialistët e DRM Korçë; mungon procesverbal-protokoll i konsultimit i mbajtur për takimin me diskutimet e pjesëmarrësve, i nënshkruar nga specialistët e DRM Korçë; në disa raste nuk identifikohen saktë studiot që kanë paraqitur raportin apo studimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Gjithashtu, procesverbalet e konsultimit nuk i janë dërguar NJVQV-ve përkatëse, ku ushtrojnë aktivitetin subjektet aplikuese për Leje të tipit B. Këto veprime janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” Kreu I, pika 1/dh, Kreu VI, pika 12,13,15,16 dhe 22 (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me AKM Tiranë të marrë masa që të plotësojnë praktikat e dhënies së mendimeve për **69 rastet** për periudhën 2015-2017, si dhe të dërgohen NJVQV-ve përkatëse regjistri i përditësuar i të dhënave për VNM- ve të Leje mjedisore.

Gjithashtu DRM Korçë dhe AKM të bashkëpunojnë dhe të marrin masa për rregullimin e normimin juridik të pikës 6 “Mendimi i DRM pas inspektimit në terren”, të formatit dhënie mendim për VNM dhe LM, me synim bërjen e tij funksional dhe sigurimin e vërtetësisë për përfshirjen e mendimit të NJVQV në VNM dhe ne lejet e tipit A.

Të merren masa masa që në të ardhmen, veçanërisht në ato raste ku publiku shpreh ankesa e mendime negative, gjatë procesit të tërheqjes së mendimit për VNM dhe Leje Mjedisore, të pasqyrojnë qartë dhe të argumentojnë dhënien e mendimit, duke i bashkëlidhur procedurës dokumentet përkatës.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM-ja Tiranë për vitin 2015 për 39 praktika mendimesh të dhëna për VNM dhe 20 procedura dhënie mendimi për Leje Mjedisore të Tipit A e B nuk ka zbatuar afatin ligjor, pasi procedura e miratimit të lejeve ka një shtrirje mbi 2 vjet, duke tejkaluar kështu afatin prej 40 ditësh të miratuar sepse miratim-refuzimet e dhënies mendimeve si dhe një pjesë e mirë e praktikave janë ende pa informacion nga AKM Tiranë në DRM Korçë lidhur me ecurinë e zbatimit të procedurave. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” Kreu II, pikat 2,4,5,6,12 dhe Kreu III, pikat 2,4,5,6,10. Të dhënat sipas tabelës së krahasimit të Regjistrimit të mendimeve për VNM dhe Lejeve Mjedisore tipi A-B për periudhën 2015-2017 bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: DRM Korçë, AKM dhe Ministria e Mjedisit të marrin masa që në procedurat e liçencimit në fazat e dhënies së mendimeve për VNM dhe të mendimeve për leje të tipit B të respektohen afatet ligjore, me synim shpejtimin dhe nxitjen e investimeve të investitorëve të brendshëm dhe të huaj. Gjithashtu, të eliminohen rastet e miratimit të lejeve mjedisore pa marrjen e mendimit nga DRM Korçë, si dhe rastet e dhënies ose tërheqjes së mendimeve për VNM e leje të Tipit A-B pas miratimit të lejeve nga strukturat eprore

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë në bashkëpunim me AKM Tiranë në të gjitha praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe për Leje Tip A e B, janë mbështetur në formate standarte dhënie mendimi për VNM dhe mendimi për Lejes Mjedisore A/B të përcaktuar në një kërkesë nr. 228, datë 3.2.2016 të Drejtorisë së Vlerësimit Mjedisor, drejtuar z. J. B. Drejtor i AKM, e cila është e pa miratuar nga Ministri. Këto formate kanë mangësi në formë, përmbajtje dhe funksion, pasi në pjesën fillestare të saj nuk janë përfshirë elementët si: “...bazuar në kërkesën nr, datë, apo email-e datë, apo në autorizimin e AKM“, ekzistenca e të cilave do bënte të mundur evidentimin dhe zbatimin e afateve të procedurës së dhënies mendimit VNM dhe mendimit për leje mjedisore tip A, B. Gjithashtu në këto formate mungojnë treguesit identifikues të pasurisë, juridiksioni i shtrirjes dhe veçanërisht ftesa për detyrimin e pjesëmarrjes së NJQV-ve përkatëse, veprime në mospërputhje me VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisi të Tipave A,B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL” shtojcën 4 dhe 5.

-Për periudhën 2015-2017, në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente plotësuese dhe mbështetëse, që dëshmojnë realizimin e procedurave si: akti i inspektimit apo aktiverifikimit në terren si dhe relacioni i

përshkrimit të procedurës me emrat e specialisteve që kanë kryer atë, dokumente këto paraprake mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi e firmosur nga drejtori i DRM Korçë.

-Në periudhën 2015-2017 të shumtën e rasteve në dhëniet e Mendimeve për VNM dhe mendimeve për Leje Mjedisore nga DRM Korçë mbi të cilat behet liçensimi nga AKM të subjekteve të paraqitura në tabelën bashkëlidhur akt-konstatimit mungon mendimi dhe ftesa për konsultim e organeve të pushtetit vendor (NJVQV). Edhe në rastet kur është mbajtur procesverbali i dëgjësës, nuk është dokumentuar mbajtja në prani të përfaqësuesve të NJVQV, si dhe nuk kanë konfirmim të tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me vendimin 419 datë 25.06.2014, Kreu VI, pika 12, ku shprehet se: “Procesverbali i dëgjësës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesmarrësit në dëgjësë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut ,palëve pjesmarrëse në dëgjësë, NJVQV-së dhe AKM-së”, si dhe me VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore (Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me AKM Tiranë të marrë masa dhe:

a. të hartojnë dhe miratojnë formate standard për dhënie mendimi për VNM dhe mendimi për Leje Mjedisore A/B, duke përfshirë në formatin tip përshkrimet: kërkesën nr, datë, apo email-e, datë, ose shprehjen: “bazuar në autorizimin e AKM”, treguesit identifikues të pasurisë a resursit, juridiksionin e shtrirjes, veçanërisht ftesën për realizimin e detyrimit ligjor të pjesëmarrjes së NJVQV-së që kanë juridiksionin territorial. Gjithashtu të përcaktojnë formatin tip të aktit të inspektimit në terren, të relacionit përkatës të specialistëve, si dhe dokumentimin e formatin e konsultimit me publikun dhe NJVQV-ët.

b. të përcaktojnë në një udhëzim të posaçëm me kritere caktuara, për rastet e verifikimit dhe përpunimit të praktikave për dhënie mendimi për VNM apo Mendimi për Leje mjedisore Tipi A-B. Në lidhje me zbatimin e kërkesave për VNM apo Mendimi për Leje mjedisore Tipi A-B të veprohet në mënyrë të njehësuar si në shqyrtimet e procedurave të dhënieve të mendimeve dhe miratimet për lejet e Tipi C, si dhe të përcaktojnë e miratojnë me udhëzim formatet përkatëse të dokumenteve mbështetëse e të përfshijnë ato në dosje për të vërtetuar realizimin e procedurave dhe justifikimin me dokumente në dhënien e mendimit për VNM dhe Leje A,B.

c. të tërheq mendimet dhe të ftojnë për konsultim NJVQV-të, në procesin e dëgjësave për dhënien e Mendimeve për VNM e për Leje Mjedisore përgatitur nga DRM Korçë mbi të cilat bëhet licencimi nga AKM të subjekteve aplikues për tërheqjen e mendimit dhe të ftojnë për konsultim NJVQV. Kjo të dokumentohet në procesverbalin e dëgjësës të mbajtur në prani të përfaqësuesve të NJVQV-ve, duke konfirmuar praninë e tyre,si dhe këto dokumente të jenë pjesë e dosjes.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për **36 subjekte** me aktivitetet “Instalimin për prodhimin e energjisë hidroelektrike të HEC” prej të cilave: **12 raste në vitin 2015, 14 raste në vitin 2016 dhe 10 raste në vitin 2017**, ka dhënë mendime për VNM praprake në **21 raste** dhe mendime për VNM të thelluar në **5 raste**, duke mos llogaritur e mbajtur parasysh si dhe vlerësuar faktorin e prishjes së regjimit natyral të rrjedhjes ujore përgjatë vitit të lumit Langaricë dhe përrenjve e burimeve ujore si burim i rëndësishëm ujor, ku regjimi i hidrocentraleve ndikon mbi florën dhe faunën në rrjedhën e përrenjve, duke ndikuar gjithashtu edhe në vënien e mbajtjen në funksion të banjave termale dhe kanioneve të lumit të Langaricës si atraksion kryesor e resurs turistik e mjekësor unikal për zonën e Kolonjës dhe Përmetit. Në dhënien e mendimeve për VNM dhe në raport-studimet e VNM, nuk janë patur parasysh proceset e hidrologjisë, morfologjisë dhe ekologjike, si dhe nuk janë vlerësuar ndikimet afatgjata të mundshme, duke mos vlerësuar florën e faunën, mbledhjen e të dhënave mbi llojet e rrezikuara. Gjithashtu në raportet e VNM-ve nuk është bërë parashikim i besueshëm në lidhje me ndikimet në biodiversitet, kushtet e ujërave

nëntokësore, si dhe pasojat për banorët (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1. Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë, të marrë masa për rishqyrtimin e verifikimin e dhënies së VNM-ve për 36 HEC-e në Qarkun Korçë, duke përfshirë në VNM dhe vlerësuar e konsideruar faktorin e prishjes a ndryshimit të rregjimit natyral të rrjedhjes së ujërave që do përdoren si burim energjie, në funksion të florës, faunës, vënies e mbajtjes funksionale të banjave termale dhe kanioneve të lumit të Langaricës si atraksion kryesor e resurs turistik e mjekësor unikal për zonën e Kolonjës dhe Përmetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13. Gjetje nga auditimi: Në studimet për VNM dhe për Leja tip B, nuk është parashikuar detyrimi i ripyllëzimit të sipërfaqeve të fondit pyjor të cilat sipas viteve për vitin 2015 luhatet nga **7 122 560 m²** si sipërfaqe e zënë në një detyrim ligjor mbi **8 373 324 m²** nga **20 subjekte**, shpërndarë sipas zërave kadastral pyje, pyje shkurre, kullota konvertuar në raportet me pikën 1,2,5 të Urdhrit të Ministrit nr. 1937, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre “;pasqyruar në tabelat përkatëse bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit “Sipërfaqet dhe Zërat Kadastral të Fondit Pyjor Kullor Nxjerre nga Studimet për VNM dhe Leje A,B, si Detyrim i pa Adresuar Ndaj Kërkuesve nga DRM Korçë në Dhënien e Mendimeve për v. 2015” (*Trajtuar në faqet 22-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandim: DRM Korçë dhe AKM Tiramë të marrin masa për rishqyrtimin e verifikimin e dhënies së VNM Paraprake për 36 HEC-e duke vlerësuar e konsideruar faktorin për identifikimin e palëve dhe llogaritjen vendosjen e detyrimeve për 7 VNM paraprake (nr.8,9,12,13,14,15 dhe nr.18 sipas tabelës) të fondit kullor prej **31800 m²**, për detyrimin e konvertuar 1;2 në sipërfaqen 63600 m² kullotë e ripërtëritur, dhe për 4 VNM Paraprake (nr. 10,11,16,dhe nr,17) për të cilat nuk janë përcaktuar sipërfaqet e zëna sipas emërimit “barishte” pra të ”fondit kullor“, e cila pasi të përcaktohet, të konvertohet në raportin 1;2 dhe përcaktohet detyrimi për ripërtëritje të fondit kullor. Mosveprime në kundërshtim me pikën 1,2,5 të Urdhrit të Ministrit nr. 1937, datë 21.10.2014 “Mbi përcaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar sipërfaqet kullimore që hiqen nga fondi pyjor dhe kullor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre “;pasqyruar në tabelën “Sipërfaqet dhe Zërat Kadastral të fondit pyjor kullor(Nxjerrë nga studimet për VNM dhe Leje A,B, si detyrim i pa adresuar ndaj kërkuesve nga DRM Korçë në dhënien e mendimeve për v. 2015”)

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për periudhën 2015- 2017 ka dhënë mendime pozitive për VNM në *27 raste* dhe mendime për Leje Mjedis në *35 raste* për aktivitetin “Gurorë”, ky mendim nuk ka marrë parasysh e llogaritur, si dhe vlerësuar faktorin e prishjes së florës e faunës, sipërfaqet pyjore-shkurre, të peisazhit natyror, duke mos paraqitur mundësinë e shfaqjes së ndikimeve apo llojin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis nga prishja e cilësisë së ajrit, rritja e nivelit të zhurmave, nga krijimi i terreneve të rrezikshme dhe rritjen e fenomenit të erozionit nga gërmimet pa kriter, nga prerjet e pyjeve, ndotja e ujërave si dhe prishja e kullotave për bagëtinë në kundërshtim me ligjin nr.10440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”neni 6 **pika 3** në të cilën përcaktohet: “*Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)*” është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.” dhe me ligjit

nr.10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” nenin 25 pika 1, 2. *(Trajtuar në faqet 89 Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1.Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë, të marrin masa për rishqyrtimin e verifikimin e **62 rasteve** të dhënies së mendimeve për VNM-ve dhe Lejeve Mjedisore për aktivitetin “Gurore” në Qarkun Korçë, duke bërë të mundur tërheqjen e vetëmonitorimeve për këto aktivitete, si dhe verifikimi në terren i tyre, me qëllim për vlerësimin e plotë të ndikimeve në mjedis.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave dhe dokumentacionit përkatës të **61 praktikave** për vitet 2015-2017, për dhënie mendimi për VNM paraprake e të thelluar për leje mjedisore Tip A e B sipas aktiviteteve: *19 praktika “Ndërtim HEC”, 16 praktika “Gurore”, 16 praktika “vend-depozitim inertesh”, 10 praktika “shfrytëzim miniera”, si dhe të 5 praktikave për dhënie mendimi për Leje të Tipit A e B për aktivitetet “Prodhim ndërtimi, nyje betoni” 11 praktika, “Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme” 1 praktikë, “Prodhim-tregtim Gaz” praktikë, “Trajtime me regjie dhe prodhim i lëkurës” 1 praktikë, Gurore 3 praktika, Miniera 6 praktika, “Venddepozitime mbetjesh inerte” 7 praktika, rezultuan mangësi në lidhje:* me mungesën e miratimit të formularëve standard, me mospërfshirjen e moscilësimit në rubrikat përkatëse të përcaktimeve të statusit të pronësor e të juridiksionit të NJVQV-ve përkatëse, me mosvendosjen e kushteve të rehabilitimit, kushteve lidhur me domosdoshmërinë e dokumentacionit që duhet mbajtur dhe mënyrën e hartimit të tyre gjatë verifikimit në terren. Konkretisht të: akt-inspektimit, aktverifikimit, relacionit të specialisteve, mendimit të NJQV-së dhe procesverbalit të konsultimit me publikun, mungon dokumenti i vetëmonitorimit të dorëzuar nga subjekti gjatë ndërtimit të veprës, mungon vlerësim i ndikimeve negative që mund të kenë në mjedis veprimtaritë e subjekteve, në disa raste mungon ftesa dhe përgjigja e NJQV dhe kur ajo ekziston në rastet e përgjigjeve negative nuk është marrë në konsideratë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.686 datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” Kreu I pika 11, pika 5, pika 1.2, me ligjin nr.10440 datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ” neni 6 pika 3, me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit” neni 44, neni 50 pika 1/b, me VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisore të Tipave A, B dhe C, për Transferimin e Lejeve nga një Subjekt tek tjetri, të Kushteve për Lejet Respektive të Mjedisit si dhe Rregullave të Hollësishme për Shqyrtimin e tyre nga Autoritetet Kompetente deri në Lëshimin e Këtyre Lejeve nga QKL” Kreu III pika 4, Kreu VI pika 12,13,15,16, shtojca 4,5 *(Trajtuar në faqet 22-130 të Projektraportit të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM Tiranë, të marrë masa për ndjekjen e procesit të lidhur me plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e munguar për dhënie “mendimi për VNM” dhe për dhënie “mendimit për leje Tipi B”, të përgatitura nga DRM Korçë, për procedurat e trajtuara në mënyrë të hollësishme sipas viteve dhe llojeve të aktiviteteve, duke iu referuar dhe tabelave sipas viteve 2015, 2016 dhe 2017 me titull: “Krahasimi i regjistrimit të mendimeve për VNM dhe Leje Mjedisore tipi A e B” të paraqitura në Aneksat e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e fondeve të alokuara nga AKM dhe të përdorura nga DRM Korçë rezulton se fondet janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të këtij Institucioni, pasi ka mungesa investimesh për pajisje zyresh dhe automjete për lëvizjen e specialistëve për kontrollin e subjekteve që pajisen me leje. Ka ambiente pune të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme për punonjësit si dhe mungon ambienti për funksionimin e arkivit dhe

protokollit. Gjithashtu mungojnë fonde për shpenzime operative, si udhëtim e dieta për udhëtime të specialistëve në territoret që kanë në kompetence ushtrimin e verifikimeve të nevojshme në terren në subjektet e pajisura me leje mjedisore, si dhe për shpenzime për larje fotosh, dokumente evidentuese të cilat janë të domosdoshme si pjesë e procedurave për pajisjen me leje mjedisore të tipit C si dhe të dhënies së mendimeve për VNM e leje të tipit A e B të subjekteve aplikuese (*Trajtuar në faqet 11,18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1.Rekomandimi: DRM Korçë t'i kërkojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, mundësinë e zgjidhjes së gjetjes së ambienteve të përshtatshme të zyrave për të krijuar kushte pune për punonjësit e kësaj drejtorie, duke përfshirë dhe krijimin e ambientit për arkiv-protokoll.Gjithashtu të shikohet mundësia e rritjes fondeve të programuara dhe të alokuara për DRM Korçë në mbështetje të funksioneve të saj

Menjëherë

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për **337 subjekte** të cilat nuk kanë sjellë vetëmonitorimin, në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit ” për mosplotësimin e kushteve të lejes dhe plotësimin e numrit të vetëmonitorimeve do të mund të aplikoheshin gjoba nga 300 mijë lekë deri 500 mijë lekë, për këtë rast të paktën kufiri minimal për vënije gjobe prej 300 mijë lekë, duke shkaktuar të ardhur të munguara per buxhetin e shtetit në vlerën **101.100 mijë lekë** ($300 \times 337 = 101,100$ mijë lekë) pra në total vlera prej **101,100 mijë lekë, konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit** (*Trajtuar në faqet 130-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunim me DR ISHMPU Korçë, të marrë masa për fillimin e procedurave ligjore e administrative për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës prej **101,100 mijë lekë** nga subjektet të cilët nuk kanë sjellë vetëmonitorimin.

Brenda muajit Shtator 2018

2. Gjetje nga auditimi: DRM Korçë për vitin 2015-2016 ka informuar zyrtarisht dhe periodikisht pranë DRISHMPU Korçë gjendjen e numrit të subjekteve të refuzuar për licencim, po pavarësisht nga kjo kanë mbetur gjë ndje në fund të vitit pa riaplikim 12 subjekte, të cilat kanë vazhduar aktivitetin pa licencim. Nga DRISHMPU Korçë nuk ka përgjigje për ndjekjen e procedurave administrative nga ndaj tyre, problem i cili është lënë në këtë stad nga dy institucionet, çka ka sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 3,600,000 lekë (12 subjekte x 300,000 lekë vlera minimale e gjobes) si pasojë e mos aplikimit të gjobave në kundërshtim me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011”Për Lejet e Mjedisit” neni 29” kundravajtjet” pika 1 germa “iiii (*Trajtuar në faqet 22-130 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandim: DRM Korçë në bashkëpunimi me DRISHMPU Korçë të vazhdojë ndjekjen e zbaytimit të ligjit për marrjen e masave administartive për kundravajtje të subjekteve të pa licencuar me leje mjedisi.

Menjëherë dhe në në vazhdimësi

D. MASA DISIPLINORE

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen

në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kombëtare e Mjedisit**, për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, për **4 punonjësit** e mëposhtëm:

1. z. G. J. me detyrë Drejtor i komanduar i DRM-së Korçë (për periudhën 17.05.2016-10.05.2017 dhe për periudhën 01.01.2018 e në vazhdim).

2. z. K.V.me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis.

3. z. V. A.me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi në Mjedis.

4. z. K.S. me detyrë ish/Drejtor i komanduar (10.05.2017-15.01.2018)

Për mangësitë dhe shkeljet konstatuar në përgatitjen e dokumentacionit të akt-miratimeve dhe akt-refuzimeve të lejeve të tipit C, mangësitë dhe parregullsitë në dokumentacionin e dhënies së mendimeve për VNM dhe dhënies së mendimeve për Leje Mjedisore të tipit A e B në kundërshtim me Ligjin nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit ” dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”

5. znj. I.K. me detyrë Specialiste monitorimi

Për mangësitë lidhur me mosplotësimin e numrit të raporteve të vetmonitorimit nga subjektet përkatëse të licencuara në kundërshtim me Ligjin nr. 10488 datë 14.07.2014 “Për lejet e mjedisit ” dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave a, b dhe c, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditmit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R